



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 93, datë 30.09.2020

PËR

DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 647, DATË 23.12.2019 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË Durrës PËR VITIN 2020, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË Durrës PËR VITET 2020-2022”

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.22, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr. 647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtorinë e AKRSKF, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në VKB nr. 647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022” sipas pasqyrës së mëposhtëme:

Nr.	Njësia shpenzuese	Llogaria ekonomike	Emërtimi projektit	Fondi në lekë viti 2020
SHTESA :				


1	Bashkia Durrës	231	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Armath , Manëz	5,833,975
2	Bashkia Durrës	231	Rikonceptmi dh rikonstruksion i shkollës së muzikës “Jan Kukuzeli”	22,666,648
3	Nd. Shërbimeve Komunale	231	Blerje automjete për Nd. Shërbimeve Komunale	17,000,000
4	Nd. Komunale Plazh	231	Blerje automjete për Nd.Komunale Plazh	7,000,000
5	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje makinerie për Ndërmarrja Rruga	13,477,860
			TOTALI FONDEVE QË SHTOHEN :	65,978,483
PAKËSIME:				
1	Ndërmarrja Rruga	600	Struktura e përkohshme për realizimin e punimeve në objektet e banimit të ndërtuar para vitit 1993	12,400,000
2	Ndërmarrja Rruga	601	Struktura e përkohshme për realizimin e punimeve në objektet e banimit të ndërtuar para vitit 1993	2,100,000
3	Ndërmarrja Rruga	602	Struktura e përkohshme për realizimin e punimeve në objektet e banimit të ndërtuar para vitit 1993	38,000,623
4	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje beton për riparim rrugësh	451,400
5	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje asfalti për rrugë urbane dhe rurale	10,869,460
6	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje material inerte për riparime për rrugë urbane dhe rurale	1,669,000
7	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje makineri vijëzimi	44,000
8	Ndërmarrja Rruga	231	Blerje automjet transporti i përzier	444,000
			TOTALI FONDEVE QË PAKËSOHEN :	65,978,483

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria e AKRSKF në Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 899 / prot.
5.


Durrës, më 02.10.2020



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.93 datë 30.09.2020 “Për disa ndryshime ne VKB nr. 647 datë 23.12.2020 Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

Nasto

